



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Bazuar në Ligjin për Arsim në Komunitet të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-068, neni 5, pika d, në neni 35, pika 1 të Ligjit për Arsim Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Nr.04/L-032, dhe të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, Nr.08/14, të dt.25.02.2014, për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorëve dhe të zv.drejtorëve të institucioneve edukativo - arsimore dhe aftësuese, Drejtoria për Arsim shpall:

KONKURS PUBLIK

(Për plotësimin e vendeve të lira të punës në institucionet edukativo-arsimore)

Drejtor në Çerdhen e fëmijëve „**Gëzimi ynë**” - Viti
Drejtor në Shkollën Filllore „**28 Nëntori**” - Verban
Drejtor në Shkollën Filllore „**Mirali Sejdiu**” - Goshicë
Drejtor në Shkollën Filllore „**Dëshmorët e Lubishtës**” - Lubishtë
Drejtor në Shkollën Filllore „**Halil Alidema**” - Pozheran

Kushtet që duhet ti plotësojnë kandidatët që konkurrojnë në këtë konkurs:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimitdhënësit, sipas Udhëzimit për licencimin e mësimitdhënëseve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimit dhe rregullativës tjetër ligjore;
- Të kenë licencë të rregullt të mësimitdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim;
- Të kenë më së paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit.

Të posedojnë këto dokumente:

- Çertifikatën e lindjes;
- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;
- Dëshminë për përvojën e punës;
- Portofolin profesionale (shih shtojcën G);

- Letër reference nga një institucion publik – kredibil (Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, DKA, këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë);
- Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuuese për punën dhe angazhimet paraprake;
- Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues, për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst, me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave me 12, arial), sipas udhëzimit të MASHT-it.
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion shëndetësor publik, me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se nuk është nën hetime;
- Kopjen e letërnjoftimit;

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë shtetit të Republikës së Kosovës, si dhe nëpër kolegje private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këtë pozitë, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, në pajtim me Udhëzimin Administrative nr.8/2010, të datës 22.06.2010. Në të kundërtën, komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve, të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet e konkursit.

Kandidatët e interesuar, aplikacionet i marrin dhe i dorëzojnë në Drejtorinë Komunale të Arsimit të Vitisë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Dokumentet e pa kompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Viti, më 17.08.2016

Drejtoria për Arsim